

Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05-350/02-236300/23 dt. 26.12.2023, në emër të aplikuesve Ajshe Zhushi, Shyqeri Maliqi dhe “Royal” SHPK, me seli në Prishtinë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në kuadër të bllokut urban “C-3”, të tërësisë urbane “C”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perendimore”, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1760-1, 1760-2, 1760-3, 1760-4, 1760-6, 1760-8, 1760-9, 1760-10, 1761-4, 1761-5, 1789-2 dhe 1789-3 ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit “zgjdhjes urbane” të prezantuar.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 05.07.2024 deri më 19.07.2024, në e-mail adresën: urbanizmi@prishtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesat shumëbanesore dhe afariste, me etazhitet -3B+S+P+12 deri -3B+S+P+14
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	53.00 m` / 13.0 m` dhe 53.00 m` / 13.0 m`
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	53.00 m` / 7.00+16.22 m` 53.00 m` / 7.30+31.64 m`
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	ISHP=40 %, e lejuar për blloku “C-3” 7368 x0.4=2947.2 m ² , e propozuar 2149.6m ²
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	ISPN=3.3, e lejuar për “C-3” (së bashku me sipërfaqen e shpronësimit) 29177.28 m ² ,
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	ISHGJ= 40 %, e kërkuar sipas Vendimit të Kryetarit, nëse aplikohen kulmet e gjelbërta duhet të sigurohet 30% në nivel të parterit
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	ISHN=60 %, e lejuar për “C-3” 4420.8 m ² , e propozuar 3531.7 m ²
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	0 vendparkime të jashtme të gjitha të siguruara nën tokë
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Po
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
n. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, si dhe shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

